



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M K.P.P. 403/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.06.2019 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-11303-02-28-2019, me objekt, “Blerje shirita plastikë me numerator për thasë”, me fond limit 6.710.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 02.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.”

Ankimues: “Trinity Trade Company” sh.p.k.
Rruga “Reshit Çollaku”, Ndërtesa.38 (P-15 katësh), H.6, Ap.3, Nj.B nr.10, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Posta Shqiptare sh.a.
Rruga “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.03.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-11303-02-28-2019, me objekt, “*Blerje shirita plastikë me numerator për thasë*”, me fond limit 6.710.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 02.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

II.2. Në datën 02.04.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 10.04.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|------------------------------------|-----------------------------------|
| 1. “Europrinty Group” sh.p.k. | 4.202.900 lekë, skualifikuar |
| 2. “Trinity Trade Company” sh.p.k. | 5.087.400 lekë, skualifikuar |
| 3. “Power Industries” sh.p.k. | 5.660.800 lekë, kualifikuar |
| 4. “Muça” sh.p.k. | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

III.4. Në datën 10.04.2019, operatori ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyt si më poshtë vijon:

“Kriteret e Vecanta dhe të Përgjithshme të Kualifikimi Operatori Ekonomik nuk plotëson kriterin dhe konkretisht:

4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip X □ Anglisht □

2.3.7 Operatori duhet të paraqes test raport për shiritat plastik në përputhje me EN ISO527/2 për qëndrueshmërinë në tërheqje nga institucionet e certifikuar, ose ekuivalente të adoptuar nga DPS siaps standartit SSHEN ISO 527-2:2012 “PLASTIK-PËRCAKTIMI I VETIVE TË TËRHEQJES” (certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlersimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga DPA,) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për sa më sipër oferta vlerësohet jo e rregullt nga KVO-ja.”

II.5. Operatori ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k. në datën 15.04.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon si më poshtë vijon:

[...] Për arsyen e parë:

-Kriteret e Vecanta dhe të Përgjithshme të Kualifikimit Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin dhe konkretisht: 4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht

Sqarojmë: Referuar Ligjit të Prokurimit Publik dhe dokumentave standarte të tenderit përkatësisht: Kriteret e Vecanta dhe të përgjithshme të kualifikimit, nuk ka kriter “4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht”. Referuar Ligjit të Prokurimit Publik dhe dokumentave standarte të tenderit i ashtuquajturit Kriter “4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht”, nuk është gje tjetër, por vetëm një informacion në lidhje me procedurën e këtij tenderi si dhe cdo procedurë tjetër dhe përkatësisht pjesë e dokumentave të përgjithshme të tenderit. Megjithatë duke iu referuar këtij sesksioni, theksojmë: I gjithë dokumentacioni i paraqitur nga ana jonë në plotësim të kërkesave për kualifikim të DT, pjesë përbërëse e ofertës së Trinity Trade Company sh.p.k., është në gjuhën shqipe. Theksojme edhe njëher, gjithë dokumentacioni i kërkuar është në gjuhën shqipe. Të gjithë dokumentat në gjuhë të huaj dhe të përkthyer dhe noterizuar, dokumenta pjesë përbërëse e ofertës janë paraqitur përkatësisht në dokumentin Nr. 15.

“15 - Dokumentacion teknik – shiritat plastik”, i cili përmban:

1- Grupi i dokumentacionit në gjuhë angleze.

- a- Katalog prodhuesi i artikullit të kërkuar me të dhënat teknike, në përputhje të plotë me specifikimet teknike të DT*
- b- Autorizim prodhuesi, lëshuar për Trinity Trade Company sh.p.k. për tenderin përkatës (dokument i kërkuar)*
- c- Certifikatë ISO 9001-2015 e kompanisë prodhuese (dokument i pakërkuar)*

- d- Certifikatë ISO 14001 – 2015 e kompanisë prodhuese (dokument i pakërkuar)
- e- Dokumentacion i përkthyer dhe i noterizuar (I kërkuar në kërkesat për kualifikim të DT)

2- Grupi I dokumentacionit në gjuhën turke

- a- Certifikatë akreditimi e laboratorit Butekom, nga institucionet përkatëse turke
Dokument shtesë (I pakërkuar në kërkesat për kualifikim të DT)

Shënim: Ky dokument është futur në këtë dokumentacion jo si një kriter vlerësimi, por si një kriter informimi i përgjithshëm nga vetë Trinity Trade Company sh.p.k., për të krijuar mundësinë e verifikimit të laboratorit Butekom, që ka bërë raport testimin përkatës.

3- Grupi i dokumentacionit në gjuhën turke

- a- Raport testimi për shiritat plastike model PM04, dokument i përkthyer dhe i noterizuar (dokument i kërkuar në kërkesat për kualifikim të DT)

Rrjedhimisht, gjithë dokumentacioni i kërkuar në kërkesat për kualifikim të DT I kësaj procedure tenderimi, dokumentacion mbi të cilin duhet të ishte bërë vlerësimi I ofertës së paraqitur, është në gjuhën e ofertës, pra në gjuhën shqipe.

Për arsyen e dytë:

“2.3.7 Operatori duhet të paraqis test raport për shiritat plastik në përputhje me EN ISO527/2 për qëndrueshmërinë në tërheqje nga institucionet e certifikuara, ose ekuivalente të adoptuar nga DPS sipas standartit SSHEN ISO 527-2:2012 “PLASTIK-PËRCAKTIMI I VETIVE TË TËRHEQJES” (certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga DPA,) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për sa më sipër oferta vlerësohet jo e rregullt nga KVO-ja.”

Sqarojmë:

Ne shtojcën 9 të DT Kërkesat e Vecanta Loti i dytë, Pika 2.3 kapaciteti teknik, në Piken 2.3.7, të ndryshuar me dokumentin "Njoftim modifikim dokumentash dt 21.03.2019, e botuar në faqen zyrtare të APP-se është kërkuar: “Operatori ekonomik, duhet të paraqesë test raport për shiritat plastike në përputhje me EN ISO 527-2 për qëndrueshmërinë në tërheqje nga institucionet e certifikuara, ose ekuivalente të adaptuar nga DPS sipas standartit SSH EN ISO 527-2:2012 "Plastike-Percaktimi i vetive të tërheqjes" (Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Referuar kërkesës së mësipërme për test raport për shiritat plastike në përputhje me EN ISO 527-2 për qëndrueshmërinë në tërheqje nga institucionet e certifikuara, ose ekuivalente të adaptuar nga DPS sipas standartit SSH EN ISO 527-2:2012 "Plastike-Percaktimi i vetive të tërheqjes" si dhe Specifikimeve teknike për lidhëset plastike ku "Testi i fuqisë në tërheqje-jo me pak se Max 40 kg/force" Sqarojmë se:

Nga Autoriteti Kontraktor Posta Shqiptare shënohet se kete procedure është kërkuar VETEM një tregues i plastike që është "Testi i fuqisë në tërheqje" dhe ky tregues i vlerësuar jo me pak 40kg/force, në përputhje me EN ISO 527-2 ose ekuivalenti shqiptar SSH EN ISO 527-2: 2012.

Në referencë të plotësimit të kësaj kërkesë Trinity Trade Company shpk ka paraqitur dokumentin Nr 15, përkatësisht:

15-Dokumentacion teknik-shiritat plastik

Në këtë dokumentacion, respektivisht faqe 11-16 ndodhet dokumenti raport-testimi, i përkthyer dhe i noterizuar.

Ne kete raport testimi ka informacion te sakte dhe lehtesisht te verifikueshem se:

- 1- Ky raport testimi eshte kryer per llogari te kompanise prodhuese Teknikplas.*
- 2- Ky raport testimi eshte kryer per lloj materiali plastike, perkatesisht shirita plastike PM04*
- 3- Ky raport testimi eshte kryer sipas standart TS EN ISO 527-2: 2012.*
- 4- Raport testimi është kryer për të gjithë treguesit e standartit TS EN ISO 527-2:2012 (referuar raportit ka të analizuar 9 tregues midis tyre dhe treguesin e kërkuar)*
- 5- Vlera e treguesit te qendrueshmerise ne terheqje (forca e keputjes) eshte 412N (42.012308 kg/ force) $1\text{ N} = 0.101972\text{ kgf}$, ne perputhje te plote me vleren perkatese te kerkuar ne ST te DT.*

Shënim: Testi i qendrueshmerise ne terheqje, apo fuqise ne terheqje, sipas inkotermave laboratorie nderkombetare, nuk eshte gje tjeter vecse forca qe perballon materiali gqe analizohet gjate terheqjes deri ne keputje, pra forca e keputjes.

Sqarojmë: TS EN ISO 527-2: 2012 dhe SSH EN ISO 527-2: 2012 eshte i njeiti standart EN ISO 527/2 (azhomimi i fundit i ketij eshte viti 2012)

Ne reference te Ligjit te Prokurimit Publik ju kujtojme: Neni 55 Kriteret e percaktimit te ofertes fitues [...].

Autoriteti kontraktor ka parashikuar, se operatoret ekonomike pjesemarres ne procedure e prokurimit, duhet te dëshmojnë se: “-Operatori ekonomik, duhet te paraqese test raport per shiritat plastike ne perputhje me EN ISO 527-2 per qendrueshmerine ne terheqje nga institucionet e certifikuara, ose ekuivalente te adaptuar nga DPS sipas standartit SSH EN ISO 527-2:2012 "Plastike-Percaktimi i vetive te terheqjes" (Certifikata duhet te jete e leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise). Autoriteti kontraktor ne asnje rast nuk ka parashikuar ne kriteret e vecanta te kualifikimit, (perfshi dhe modifikimin e dokumentave te tenderit) se krahas dorezimit te ketij dokumenti (test raport), operatoret ekonomike pjesemarres duhet te deshmojne me dokumente shtese provues se subjekti leshues i certifikates apo certifikata duet te jete e leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizata nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Njesia e prokurimit prane autoritetit kontraktor si njesia pergjegjese per pergatitjen e dokumenteve te tenderit dhe mbledhjen e te gjitha materialeve te nevojshme qe u bashkelidhen atyre, perfshire hartimin e kriterëve te vecanta per kualifikim dhe specifikimet teknike ne asnje rast ne shtojcen 9 Kriteret e Vecanta te Kualifikimit (perfshi dhe modifikimin e dokumentave te tenderit) nuk ka parashikuar se ne permbushje te kriterit te sipercituar, krahas dorezimit te Test -raportit ne perputhje me EN ISO 527-2, pjesemarresit duhet te dorezojne njeherazi edhe deshmi se subjekti certifikues eshte i njohur nga sistemet e akreditimit kombetar ose nderkombetar.

Vleresimi i ofertave referuar kriterëve te tjera te kualifikimit te cilat ne asnje rast nuk jane parashikuar ne dokumentet e procedures se prokurimit jo vetem qe eshte ne kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-se, por cenon gjithashtu parimet kryesore te zhvillimit te procedures se prokurimit, parashikuar nga neni 2 i LPP-se, ate te barazise ne trajtimin e kerkesave dhe detyrimeve qe i ngarkohen ofertuesve. Operatoret ekonomike duhej te jene ne nje pozicion barazie, si kur pergatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur te vleresohen ato.

Per sa kohe qe autoriteti kontraktor nuk ka kerkuar ne dokumentet e procedures se prokurimit ne asnje rast dorezimin e dokumenteve provues "Certifikata duet te jete e leshuar nga organizmat e

vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise). autoriteti kontraktor nuk mund te shqyrtoje, vleresoje dhe gjykoje mbi shkaqet e mesiperme te s'kualifikimit sepse ne asnje rast nuk eshte kerkuar/parashikuar nga autoriteti kontraktor detyrimi i dorezimit te dokumentacionit proves. Megjithese nuk eshte kerkuar nje dokumentacion i tille dhe normalisht interpretimet tona duhet te mbaronin këtu, sqarojmë se detyrime të tilla janë lehtësisht të verifikueshme.

Sqarojme se:

-DPA, (Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit) eshte anetar me te drejta te plota ne EA (Organizatën Europiane per Akreditim).

-TURKAK (Turkish Acreditation Agency, Agjencia Turke e Akreditimit, ekuivalente me DPA) eshte anetar me te drejta te plota ne EA (Organizaten Europiane per Akreditim)

-DPA,- TURKAK dhe shume agjenci te tjera jane nenshkruese te marreveshjes EA MLA
EA MLA eshte nje marreveshje e nenshkruar midis organeve kombetare të akreditimit – (Full and Associate Members of EA).

Anetaret me te drejta te plota dhe te asocijuar te EA- njohin ekuivalencen, besueshmerine dhe per kete arsye pranimin nga tregu evropian, te certifikimit, verifikimit, inspektimit, certifikatat e kalibrimit dhe raportet e testimit të lëshuara nga organet e akredituara te vleresimit te konformitetit

Ne anglisht

“The EA MLA is an agreement signed between national accreditation bodies- Full and Associate Members of EA recognise the equivalence, reliability and therefore acceptance by the European market, of certification, verification, inspection and calibration certificates and test reports issued by accredited conformity assessment bodies.”

I gjithë ky dokumentacion, lehtësisht i verifikueshem, ndodhet ne faqen elektronike zyrtare te DPA, Kujtojmë anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të ankesës që të bazohën: Ne DT- Kapitulli II- Seksioni 1, pika 1.1 Hartimi i ofertes, Oeratoret Ekonomike jane te detyruar te pergatisin oferta, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne keto DT.

Vendimi i KVO-se per mos kualifikimin e Ofertes se paraqitur nga Trinity Trade Company shpk per tenderin me objekt "Blerje shirta plastike me numerator pa thase", Ne perputhje me dokumentat e tenderit dhe LPP, Trinity Trade Company shpk, ka paraqitur nje oferte serioze, kor Prandaj ne baze te LPP, te VKM per RRPP te DT dhe argumentave dhe fakteve te dhena nga ana jone, kerkojme:

1-Shfuqizimin e vendimit te KVO- se dhe shpalljen e Ofertes se Trinity Trade Company shpk si “Oferte e Kualifikuar”.

2- Marrjen e masave administrative dhe ligjore ndaj anetareve te Kvo-se.

II.6. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 19.04.2019, me anë të shkresës nr.636/13 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë, me argumentin si më poshtë:

“[...] Lidhur me pretendimin Tuaj se "nuk permbushet pika 2.3.7 e Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit Kapaciteti Teknik", ju sqarojme se:

Kriteret per kualifikim vendosen që ti sherbejnë Autoritetit Kontraktor per te krijuar nje panoramë te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushjen me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj Autoriteti Kontraktor percakton kërkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesmarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te pa pranueshme.

Neni 55 pika 2 e LPP-se parashikon se "Autoriteti kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, per te percaktuar oferten fituese, ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet te perdoret asnje kriter, qe nuk eshte perfshire ne dokumentet e tenderit".

Ne pike 2.3.7 te DST eshte kerkuar qe: "Operatori ekonomike, duhet te paraqese test raport per shiritat plastike ne perputhje me EN ISO 527-2 per qendrueshmerine ne terheqje nga institucionet e certifikuara, ose ekuivalente te adaptuar nga DPS sipas standartit SSH EN ISO 527-2: 2012" Plastike-Percaktimi vetive te terheqjes" (Certifikata duhet te jete e leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise).

EN-ISO 527-2 eshte standart qe percakton kushtet e testimit dhe vetive te terheqjes se materialeve plastike, bazar ne parimet e pergjithshme te dhena ne ISO 527-1. Sqarojme se kjo e fundit percakton parimet e pergjithshme per percaktimin e vetive elastike te matetialeve plastike nen kushte te percaktuara. Ne dokumentat e paraqitura ne sistemin elektronik te Agjensise se Prokurimit Publik, ne permbushje te pikes 2.3.7 keni paraqitur nje raport testimi te leshuar nga laborator i Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lekures BUTEKOM, i cili nuk eshte ne perputhje me kriterin e sipercituar pasi ky test nuk eshte kryer sipas standart EN ISO 527-2. Lidhur me kete sqarojme se: Nga Agjensia e Prokurimit Publik Nr. Prot. 3330 Date 20.03.2018 dhe Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit me shkresen Nr. prot. 145 date 16.03.2018, ne piken 4 te saj percaktohet "Te gjitha certifikatat e cilesise, te cilat vlerësohen te nevojshme ta kerkohen nga Autoriteti Kontraktor, duhet te jene te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituar nga DPA, ose organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Ky rekomandim eshte i shoqeruar dhe me manualin teknik "Mbi menyren e marrjes se informacionit per organet e vleresimit te konformitetit te akredituar nga DPA/organizmat akreditues te huaj, te cilet kane nenshkruar marreveshjen reciprocitetit me Republiken e Shqiperisë. Referuar ketij manuali komisioni ju referua adreses elektronike <http://ëëë.european-acreditation.org> dhe verifikoi subjektin qe ka realizuar kete Test Raport te materialit "Plastic". Sipas dokumentacionit teknik te paraqitur nga Operatori Ekonomik "TRINITY" rezultojne keto dokumenta si me poshte:

Se pari. Certificate Akreditimi i TURKAK e cila ishte e pa perkthyer dhe e panoterizuar.

Komisioni i shqyrtimit te ankesave gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur certificate akreditimi, pasi mungesa e perkthimit te Certifikates ose e fragmenteve saj, nuk lejon kryerjen e specifikimit te qarte te akreditimit te certifikates, gje kjo e cila do te sherbente si garanci per autoritetin kontraktor, per permbushjen me sukses te objektit te prokuruar, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit. KSHA sqaron se eshte detyre e operatorëve ekonomike që te garantojne qe oferta e paraqitur nga secili prej tyre te perfshije te gjithë elemente e kerkuar nga AK me qellim garantimin e nje kontrate te suksesshme.

Gjithashtu dhe ne dokumnetat standarte te tenderit eshte e percaktuar se gjuha per hartimin e ofertave ose kerkesave per pjesemarrje do te jete gjuha shqipe.

Se dyti. Raporti i Testimit i leshuar nga BUTEKOM, laborator i certifikuar nga TURKKAK si organizem akreditues i huaj i njohur nga DPA, nga verifikimi ne sistem te subjektit BUTEKOM rezulton se nuk eshte i certifikuar per material "Plastik" sipas standartit SSHEN ISO 527-2: 2012, por vetem per tekstil

Per sa me sipër, tekstili nuk hyn ne fushen per te cilen ky laborator eshte akredituar dhe si rrjedhoje test raport i paraqitur prej jush nuk eshte i vlefshem pasi ky laborator nuk teston plastik dhe si pasoje nuk mund te perdor metoden e testimit EN ISO 527-4 per plastiken sipas kerkesave te DST-ve. Per sa me sipër, pretendimi Juaj nuk qendron.

Vleresimi i ofertes te ofertuar ne kete procedure eshte ne zbatim dhe mbeshetje te pikes 3, te nenit 53, Shqyrtimi i Ofertave, te Ligjit Nr. 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" (me ndryshimet), ku citohet: Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit, pa rrene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji. Ankesa e paraqitur nga ana juaj, është shqyrtuar me shumë vëmendje nga autoriteti ynë kontraktor dhe pretendimet e paraqitura në ankesë nuk qëndrojnë.

II.7. Në datën 26.04.2019 operatori ekonomik "Trinity Trade Company" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1235/1 prot., datë 08.05.2019, protokolluar me tonën në datën 09.05.2019, me objekt "Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje shirita plastikë me numëror për thasë", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Trinity Trade Company" sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike "Operatori duhet të paraqes test raport për shiritat plastik në përputhje me EN ISO527/2 për qëndrueshmërinë në tërheqje nga institucionet e certifikuar, ose ekuivalente të adoptuar nga DPS siaps standartit SSHEN ISO 527-2:2012 "PLASTIK-PËRCAKTIMI I VETIVE TË TËRHEQJES" (certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlersimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga DPA,) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për sa më sipër oferta vlerësohet jo e rregullt nga KVO-ja.", nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit, të procedurës së mësipërme të prokurimit, pika 2.3.7 e “Kapacitetit teknik”, është modifikuar si më poshtë:

“Pika 2.3.7: Për kapacitetin teknik: ISHTE:

Operatori ekonomike, duhet të paraqesë test raport për shiritat plastike në përputhje me EN ISO 527-2 për qendrueshmërinë në tërheqje nga institucionet e certifikuara.

Pika 2.3.7: Për kapacitetin teknik: BËHET:

Operatori ekonomike, duhet të paraqesë test raport për shiritat plastike në përputhje me EN ISO 527-2 për qendrueshmërinë në tërheqje nga institucionet e certifikuara, ose ekuivalente të adaptuar nga DPS sipas standartit SSH EN ISO 527-2:2012 “Plastikë – Përcaktimi i vetive të tërheqjes” (Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).”

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP konstaton se operatori ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k., ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Raport testimi Nr. 2019-0310, i lëshuar nga “BUTEKOM” për subjektin “Teknikplas”, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar;
2. Autorizim prodhuesi lëshuar nga shoqëria “Teknikplas” Ltd, për shoqërinë “Trinity Trade Company” sh.p.k.

III.1.3. Në nenin 46 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese[...]*”

Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”*

III.1.4. Në nenin 27 pika 6 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se:

“6.Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) *dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose*

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.5. Në nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.1.6. Operatori ekonomik ankimes pretendon: Autoriteti kontraktor ka parashikuar, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë të prokurimit, duhet të dëshmojnë se: “-Operatori ekonomik, duhet të paraqesë test raport për shiritat plastike në përputhje me EN ISO 527-2 për qëndrueshmërinë në tërheqje nga institucionet e certifikuara, ose ekuivalente të adaptuar nga DPS sipas standartit SSH EN ISO 527-2:2012 "Plastike-Percaktimi i vetive të tërheqjes" (Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë). Autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka parashikuar në kriteret e vecanta të kualifikimit, (përfshi dhe modifikimin e dokumentave të tenderit) se krahas dorezimit të këtij dokumenti (test raport), operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë me dokumente shtesë provues se subjekti lëshues i certifikatës apo certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Njesia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor si njesia përgjegjëse për përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkelidhen atyre, përfshire hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike në asnjë rast në shtojcën 9 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit (përfshi dhe modifikimin e dokumentave të tenderit) nuk ka parashikuar se në përmbushje të kriterit të sipërcituar, krahas dorezimit të Test -raportit në përputhje me EN ISO 527-2, pjesëmarrësit duhet të dorezojnë njëherazi edhe dëshmi se subjekti certifikues është i njohur nga sistemet e akreditimit kombëtar ose ndërkombëtar.

Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjerë të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-se, por cenon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i LPP-se, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit në asnjë rast dorezimin e dokumenteve provues "Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë). autoriteti kontraktor nuk mund të shqyrtojë, vlerësojë dhe gjykojë mbi shkaqet e mesipërme të s'kualifikimit sepse në asnjë rast nuk është kërkuar/parashikuar nga autoriteti kontraktor detyrimi i dorezimit të dokumentacionit provës. Megjithatë nuk është kërkuar një dokumentacion i tillë dhe

normalisht interpretimet tona duhet te mbaronin këtu, sqarojmë se detyrime të tilla janë lehtësisht të verifikueshme.

III.1.7. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton se:

Ne pike 2.3.7 te DST eshte kerkuar qe: "Operatori ekonomike, duhet te paraqese test raport per shiritat plastike ne perputhje me EN ISO 527-2 per qendrueshmerine ne terheqje nga institucionet e certifikuar, ose ekuivalente te adaptuar nga DPS sipas standartit SSH EN ISO 527-2: 2012" Plastike-Percaktimi vetive te terheqjes" (Certifikata duhet te jete e leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise).

EN-ISO 527-2 eshte standart qe percakton kushtet e testimit dhe vetive te terheqjes se materialeve plastike, bazar ne parimet e pergjithshme te dhena ne ISO 527-1. Sqarojme se kjo e fundit percakton parimet e pergjithshme per percaktimin e vetive elastike te matetialeve plastike nen kushte te percaktuara. Ne dokumentat e paraqitura ne sistemin elektronik te Agjensise se Prokurimit Publik, ne permbushje te pikes 2.3.7 keni paraqitur nje raport testimi te leshuar nga laborator i Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lekures BUTEKOM, i cili nuk eshte ne perputhje me kriterin e sipercituar pasi ky test nuk eshte kryer sipas standart EN ISO 527-2. Lidhur me kete sqarojme se: Nga Agjensia e Prokurimit Publik Nr. Prot. 3330 Date 20.03.2018 dhe Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit me shkresen Nr. prot. 145 date 16.03.2018, ne piken 4 te saj percaktohet "Te gjitha certifikatat e cilesise, te cilat vlerësohen te nevojshme ta kerkohen nga Autoriteti Kontraktor, duhet te jene te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituar nga DPA, ose organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Ky rekomandim eshte i shoqeruar dhe me manualin teknik "Mbi menyren e marrjes se informacionit per organet e vleresimit te konformitetit te akredituar nga DPA/organizmat akreditues te huaj, te cilet kane nenshkruar marreveshjen reciprocitetit me Republiken e Shqiperise. Referuar ketij manuali komisioni ju referua adreses elektronike <http://www.european-accreditation.org> dhe verifikoi subjektin qe ka realizuar kete Test Raport te materialit "Plastic". Sipas dokumentacionit teknik te paraqitur nga Operatori Ekonomik "TRINITY" rezultojne keto dokumenta si me poshte:

Se pari. Certificate Akreditimi i TURKAK e cila ishte e pa perkthyer dhe e panoterizuar.

Komisioni i shqyrtimit te ankesave gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur certificate akreditimi, pasi mungesa e perkthimit te Certificate ose e fragmenteve saj, nuk lejon kryerjen e specifikimit te qarte te akreditimit te certificate, gje kjo e cila do te sherbente si garanci per autoritetin kontraktor, per permbushjen me sukses te objektit te prokuruar, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit. KSHA sqaron se eshte detyre e operatoreve ekonomike qe te garantojne qe oferta e paraqitur nga secili prej tyre te perfshije te gjithë elemente e kerkuar nga AK me qellim garantimin e nje kontrate te suksesshme. Gjithashtu dhe ne dokumnetat standarte te tenderit eshte e percaktuar se gjuha per hartimin e ofertave ose kerkesave per pjesemarrje do te jete gjuha shqipe.

Se dyti. Raporti i Testimit i leshuar nga BUTEKOM, laborator i certifikuar nga TURKKAK si organizem akreditues i huaj i njohur nga DPA, nga verifikimi ne sistem te subjektit BUTEKOM rezulton se nuk eshte i certifikuar per material "Plastik" sipas standartit SSHEN ISO 527-2: 2012, por vetem per tekstil

Per sa me sipër, tekstili nuk hyn ne fushen per te cilen ky laborator eshte akredituar dhe si rrjedhoje test raport i paraqitur prej jush nuk eshte i vlefshem pasi ky laborator nuk teston plastik dhe si pasoje nuk mund te perdor metoden e testimit EN ISO 527-4 per plastiken sipas kerkesave te DST-ve. Per sa me siper, pretendimi Juaj nuk qendron.

III.1.8. Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar rekomandimi mbi hartimin e kërkesave të cilësisë i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, datë 20.03.2018 (data e protokollimit pranë APP), shoqëruar me Manualin teknik “Mbi mënyrën e marrjes së informacionit për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit/organizma akreditues të huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen e reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë rekomandim, është përcaktuar: “Të gjitha certifikatat e cilësisë, të cilat vlerësohen të nevojshme të kërkojnë nga autoriteti kontraktor, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

Gjithashtu, në manualin teknik, përcaktohen mënyrat, se si merret informacioni për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit/organizma akreditues të huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen e reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë.

Në këtë manual janë të përcaktuara detajet në lidhje me organet e vlerësimit të konformitetit (OVK), organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, mënyrën se si mund të merret informacioni nëse një OVK është i akredituar apo jo nga DPA, mënyrën se si mund të merret informacion nëse certifikata apo raporti i lëshuar nga OVK e akredituar është aktualisht i vlefshëm, si mund të merret informacion nëse një OVK është akredituar nga organizma akreditues të huaj, mënyrën si mund të gjendet që një OVK është e akredituar nga një organizëm akreditues dhe cila është fusha e akreditimit. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, i cili sqaron se, ka kryer verifikimet përkatëse në lidhje me raport testimit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes, si edhe nga verifikimi i kryer nga KPP, bazuar në këtë manual, Raport Testimi Nr. 2019-0310 lëshuar në drejtim të shoqërisë “Teknikplas”, rezulton se, ka mangësi dhe nuk është sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga shoqëria “Trinity Trade Company” sh.p.k., KPP konstaton se ky i fundit ka paraqitur Raport Testimin Nr. 2019-0310 për materialin “plastikë”, të lëshuar nga BUTEKOM në Turqi, sipas standartit TS EN ISO 527-2:2012. Nga verifikimi referuar edhe manualit teknik, sipas të cilit DPA njeh të barazvlefshëm certifikata/raporte të lëshuara nga organet akredituese që kanë nënshkruar marrëveshje të njohjes reciproke, rezulton se në Turqi, TURKAK është organ kombëtar i akreditimit, ashtu si edhe DPA në Shqipëri, dhe është e njohur nga EA. Nga verifikimi në faqen zyrtare të TURKAK, rezulton se subjekti BUTEKOM që ka lëshuar Raport Testimin Nr. 2019-0310 të dorëzuar në këtë procedurë nga shoqëria “Trinity Trade Company” sh.p.k., është i akredituar nga TURKAK për të kryer disa teste, ku janë përcaktuar materiali/produkti që ky subjekt mund të testojë, emri i eksperimentit dhe metodat e testimit sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare, nga ku rezulton se subjekti BUTEKOM nuk është i akredituar për të kryer teste për materialin “plastikë” sipas standartit TS EN ISO 527-2:2012, kërkesë kjo e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Pra, sa më sipër, për sa kohë autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht në dokumentat e tenderit që operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin test raport për shiritat plastike

në përputhje me EN ISO 527-2 për qendrueshmërinë në tërheqje nga institucionet e certifikuara, ose ekuivalente të adaptuar nga DPS sipas standartit SSH EN ISO 527-2:2012 “Plastikë – Përcaktimi i vetive të tërheqjes”, dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në këtë procedurë prokurimi, nuk është i vlefshëm, pasi subjekti “BUTEKOM” që ka lëshuar këtë raport nuk është i akredituar për të kryer testime për materialin plastikë, sipas standartit EN ISO 527-2:2012.

III.1.9. Sa më sipër, KPP sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

III.1.10. Akoma më tej, në rast se operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor përsa i përket dokumentave të tenderit, publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së.

Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin

e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, por do të mbetet i skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke mos përmbushur interesin e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. *REF-11303-02-28-2019*, me objekt, “*Blerje shirita plastikë me numerator për thasë*”, me fond limit 6.710.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 02.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 764 Protokolli

Datë 26.04.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha